



Bashkia Shkodër


Raporti Vjetor i Performancës 2018

DISCLAIMER:

Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit të bashkisë Shkodër gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak. Dokumenta bazë referuese janë Raporti i Monitorimit 2018 dhe informacioni i ofruar nga bashkia. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Shkodër me asistencën e Projektit Bashki të Forta.


PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
TË ARDHURAT.....	4
SHPENZIMET.....	5
SEKTORËT STRATEGJIK.....	9
ADMINISTRIMI I BASHKISË DHE MARRËDHËNIA ME KOMUNITETIN.....	10
SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA RRUGORE.....	11
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMI.....	13
MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT.....	14
MENAXHIMI I MJEDISIT, PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	16
ARSIMI DHE EDUKIMI.....	17
SHËRBIMET SOCIALE DHE STREHIMI.....	19
KULTURA DHE SPORTI.....	21
MBROJTJA NGA ZJARRI.....	23





TERRITORI ADMINISTRATIV



11 njësi administrative, 1 qytet dhe 93 fshatra

Popullsia 204,954 (56% në qytet),
(140,000 Cencus 2011),

Familje 62,671 (59% në qytet),

TF 873 km2 (50 herë më të madh se ish Bashkia Shkodër).


135 banorë/km².

Qyteti ka 1,150 ha shtrirje fushore, 350 ha e zënë kodrat.



VOLTANA ADEMI
Kryetare e Bashkisë


Përbërja e Këshillit Bashkiak Gjithësej 51 Anëtarë



TË ARDHURAT

Të ardhurat	Plan 2018	Fakt 2018
Të ardhura të arkëtuara dhe të trashëguara nga viti i mëparshëm	1,050,504	895,245
Transferta e pakushtëzuar	870,475	809,059
Transferta Specifike	404,350	379,815
Transferat e Kushtëzuar	1,005,408	988,517
Të ardhura nga grante ndërkombëtare	11,844	8,186
TOTALI	3,342,581	3,390,484

Të ardhurat sipas burimit në mijë lekë




Totali i planit të të ardhurave buxhetore për periudhën 12/mujore shkon në 3,342,581 mijë lekë,

- Plani i të ardhurave nga burimet e veta si 12 mujor **1,050,504** mijë lekë
- Fakti i të ardhurave nga burimet e veta 12 mujor **895,245** mijëlekë


Është realizuar **85.2%** e planit.

Mos-realizimi në vlerë: **155,259** mijë lekë ose **14.8%** e planit e mbi realizuar.

Raporti i të ardhurave



RAPORTI MES TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE



Treguesi i Performancës:

Përmirësimi i mbledhjes të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore i viti korent kundrejt vitit të kaluar:


32%

Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme rezulton në masën

92,3%

SHPENZIMET

REALIZIMI I SHPENZIMEVE



Totali i shpenzimeve të realizuara është **3,128,729** mijë lekë. Transferimet zënë **34%** të Shpenzimet Operative zënë **25%**, Investimet zënë **21%** dhe Pagat e sigurimet zënë **20%** të shpenzimeve të përgjithshme.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE KRAHASUAR ME PLANIN

PLANIFIKIM, ADMINISTRIM

96%

INFRASTRUKTURA RRUGORE

95%

SHËRBIMET PUBLIKE

96%

Mbështetja e programit të Admnsitratës Vendore ka për qëllim krijimin dhe mbështetjen e një strukture menaxhuese sa më cilësore e funksionale, që të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë. Përthithja e burimeve njerëzore profesionale në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë e ka qenë pjesë e rëndësishme e punës gjatë vitit 2018. Në fokus të Bashkisë së Shkodrës kanë qenë formalizimi, përmirësimi i punës dhe shërbimeve administrative, dhe rritja e transparencës

Krijimi i territorit të ri administrativ të bashkisë – shumë – qendërsh duke përfshirë qytetin e Shkodrës dhe fshatrat e 10 njësive administrative të programin e infrastruktures rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuarëve dhe shesheve publike të tij.

Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimin e shërbimit.

Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit, monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

SHPENZIMET

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL



Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë. Synimi afatgjatë kryesor është racionalizimi i modelit të fshatrave përsa i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

MJEDISI, PYJET DHE KULLOTAT



Ky program mbulon sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet permiresimit të cilësisë dhe reduktimit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes akustike. Ky program ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, etj.

ARSIMI DHE EDUKIMI



Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare

STREHIMI DHE SHËRBIMET SOCIALE



Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

KULTURA DHE REKREACIONI



Shkodra, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë referencë të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj.

EMERGJENCAT CIVILE



Zvogëlimi i rrishtit nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.


SHPENZIMET

RINIA DHE SPORTET



Rinia është pjesë e përvitshme e aktiviteteve sportive dhe zhvillimit të sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubit sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

PLANIFIKIMI URBAN



Programi i menaxhimit të territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me të gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI



Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

TRANSPORTI PUBLIK




Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes. Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës. Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane

SHPENZIMET

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE PËRKUNDREJT SHPENZIMEVE TË PËRGJITHSHME

Programi Buxhetor	Plan	Fakt
Strehimi dhe shërbimet sociale	1,021,135	1,014,510
Shërbimet publike	393,331	377,983
Arsimi parauniversitar dhe edukimi	370,110	352,266
Infrastruktura rrugore	343,341	325,683
Programi i administratës vendore	317,961	305,010
Rinia dhe sportet	139,136	125,664
Kultura dhe shërbimet rekreative	85,776	72,122
Emergjencat civile	55,340	50,194
Bujqësia dhe zhvillimi rural	37,007	32,103
Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve dhe kullotave	18,099	12,821
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	16,799	12,053
Transporti publik dhe lëvizshmëria	13,712	6,943
Planifikimi urban	11,461	5,396



SEKTORËT STRATEGJIK



STRATEGJIA E BASHKISË

“Shkodra me njerëzit kreativ, historinë e kulturën, mikpritjen e burimet natyrore, një komunitet që jeton e zhvillohet, derë e hapur për integrim”



ARSIMI DHE EDUKIMI

Janë përmirësuar kushtet në çerdhet, kopshtet dhe shkollat ekzistuese të qytetit dhe njërive administrative.

SHËRBIMET SOCIALE DHE STREHIMI

Janë ngritur 12 qendra komunitare në të cilat ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrijtje dhe shërbime. Është vënë në funksion Qendra e pare Rinore Publike.

KULTURA DHE SPORTI

Janë rivitalizuar institucionet aktuale të kulturës dhe sportit në Shkodër, ruajtja dhe promovimi i trashigimisë kulturore dhe sportive i zonave të ndryshme të territorit.

INFRASTRUKTURA RRUGORE


Bashkia ka shtruar rrugë të reja dhe ka mirëmbajtur rrugët ekzistuese. Është punuar për përmirësimin e sinjalistikës dhe ndriçimit rrugor rural dhe urban.

SHËRBIMET PUBLIKE

Janë shtuar hapësirat e gjelbërta dhe është mirëmbajtur qyteti çdo ditë. Transporti dhe menaxhimi i mbetjeve është përmirësuar ndjeshëm.


EMERGJENCAT CIVILE

Bashkia ka kryer investime në sektorin e emergjencave civile dhe ka menaxhuar me sukses raste të shuarjes së zjarreve.



ADMINISTRIMI I BASHKISË DHE MARRËDHËNIA ME KOMUNITETIN

ADMINISTRIMI I STAFIT TË BASHKISË



Treguesit e Performancës:

Nëpunës të larguar gjatë vitit: **16**

Masa disiplinore të marra: **0**

Ditët totale të trajnimit: **137**

Nëpunësit total të trajnuar: **37**

Qëndrueshmëria e stafit të bashkisë gjatë vitit 2018 është **94%**

Ngritja e kapaciteteve e administratës së bashkisë është **3.7 ditë**

Mbështetja e programit të Admnsitratës Vendore ka për qëllim krijimin dhe mbështetjen në vazhdimësi të një strukture menaxhuese sa më cilësore e funksionale, që të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë.

Përthithja e burimeve njerëzore profesionale në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës ka qenë pjesë e rëndësishme e punës gjatë vitit 2018. Në fokus të Bashkisë së Shkodrës kanë qenë formalizimi dhe përmirësimi i punës dhe shërbimeve administrative, dhe rritja e transparencës.

Marrëdhënia me Komunitetin

Numri i konsultimeve me komunitetin gjatë vitit 2018

15

Diskutimet dhe komunikimet me komunitetin e saj kanë rezultuar në mire qeverisje duke rezultuar në marrjen në considerate shqetësimet dhe sugjerimet e qytetarëve të qasqyruara në vendimet e marra.


Numri i vendimeve të marrë në konsultim me publikun

9


Treguesi i Performancës:
Vendimmarrja në konsultim me komunitetin është në masë **60%**

Realizimi i Shpenzimeve

■ Fakti
■ Plani



Shpenzimet e Programit në raport me Shpenzimet e Përgjithshme




SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA RRUGORE




Mirëmbajtje e infrastrukturës publike

■ 2017 ■ 2018



■ 2017 ■ 2018



Realizimi i Shpenzimeve Shërbime Publike

Paga dhe Sigurime	84%
Shpenzime Operative	97%
Transferime	98%
Investime	92%


Ofrimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjise si dhe zgjerimin e shërbimit.

Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit, monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

Masa mbrojtëse në infrastrukturën publike

■ 2017 ■ 2018



SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA RRUGORE

Treguesit e Performancës:

Mirëmbajtje / Zgjerim i rrjetit rrugor:	Raporit i rrjetit rrugor operativ në km kundrejt vitit të kaluar (në %):	5%
	rrugë rurale	-9%
	rrugë urbane	56%
Përmirësimi i shërbimit të varrezave	Investime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (ndryshimi në %)	-5%

Treguesit e Performancës:

2017

2018

Eficienca e alokimit të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore:	Buxheti në Lekë i shpenzuara për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në km (Lekë për 1 km rrugë (kosto operative dhe mirëmbajtje)	78,616	59,443
	rrugë rurale	103,113	82,959
	rrugë urbane	36,970	33,652
Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit: Shpenzime për 1 tonë mbetje të menaxhuar	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Lekë për 1 tonë mbetje (kosto operative dhe mirëmbajtje plus investime)	4,063	4,267
Përmirësimi i efikasitetit të buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik	Lekë të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (raporti në %)	6721	503


Realizimi i Shpenzimeve Infrastruktura Rrugore

Shpenzime Operative 10%

Investime 90%

Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme Infrastruktura Rrugore

■ Shpenzime të Programit (10%)




Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme

Shërbimet Publike

■ Shpenzime të Programit (12%)

■ Shpenzime të Përgjithshme



ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMI

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmjet tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuësve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektorial, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

14 projekte




të aplikuara në Programet e Financimeve të BE

1 treg



i rehabilituar me një investim prej 11,571 mijë lekë

15 panairë



të organizuara në promovim të vlerave dhe burimeve të gjithë territorit të bashkisë

10 botime



Informuese për burimet e zhvillimit ekonomik të territorit të bashkisë

1

inisiativë biznesi



e mbështetur për hapjen e aktivitetit në qytetin e Shkodrës dhe punësimin e të rinjve

5 materiale promovuese



të publikuara në mbështetje të promovimit të bashkisë

1 platformë



e ngritur për akses më të mirë të informacionit nga qytetarët, vizitorët dhe investitorët

8 festa



turistike të organizuara në të gjithë territorin e bashkisë

1 zyrë turistike




funkionale në shërbim të informacionit për të gjithë turistët vendas apo të huaj


Treguesit e Performancës:

Promovim më i mirë i biznesit vendor	Numri i panairëve me produkte dhe shërbime vendore – ndryshimi në % midis vitit korent kundrejt vitit të kaluar	275%
Numri tregjeve të rregulluara nga bashkia	Numri i tregjeve funksionale	1

Realizimi i Shpenzimeve të programit në mijë lekë



Shpenzimet e Programit në raport me Shpenzimet e Përgjithshme



MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Ujitja			Kullimi		
	Sasia Fakt	Vlera (në mijë lekë)		Sasia Fakt	Vlera (në mijë lekë)
Kanale ujtëse të mirëmbajtur, pastruar dhe përmirësuar	106 km	12,229	Kanale kulluese të mirëmbajtur, pastruar dhe përmirësuar	105,98 km	
Mirëmbajtje e skemës së ujitjes	8 km	6,721	Sipërfaqja e rehabilituar për mbulim me kullim	3,003 Ha	
Debitorë për tarifat e ujitjes	0	FALAS	Volumi i dherave të lëvizur	162.021 m ³	
Kanale ujtëse në total	213 km	7,346,000	Kanale kullues në total	139.7 km	12,229,000

Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë.

Synimi afatgjatë kryesor është racionalizimi i modelit të fshatrave përta i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

- 43% e popullsisë së Bashkisë Shkodër jeton në zonat rurale.
- Numri i fermave bujqësore është rreth 11,
- Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë
- ka trashëguar 213 km kanale ujtëse
- ka trashëguar 622.7 kanale kulluese

Objektivat:

- ☞ Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit
- ☞ Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkohore. Përmirësimi i dokumentacioneve përkatëse të pronësive private
- ☞ Krijimi i databazës së informacionit bujqësor. Krijimi i strukturs keshillimit bujqësor
- ☞ Përdorimi i granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural


Treguesit e Performancës

Përmirësimi i shërbimit	Sipërfaqe e mbuluar me ujitje ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	16%
	Sipërfaqe e mbuluar me kullim – rritja në % kundrejt vitit të kaluar	131%


MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Treguesit e Performancës		2017	2018
Përmirësimi i mbështetjes financiare për shërbimin ujitje-kullim: Lekë të shpenzuara për 1 km kanal kullues	Buxheti i shpenzuar për kullim kundrejt kilometrave total te sistemit kullues Lekë/për km (kosto operimi)		31%
Përmirësimi i rrjetit kullues	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	8%	19%
Përmirësimi rrjetit ujitës	Km kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	7%	8%

Realizimi i shpenzimeve të programit në mijë lekë



Shpenzimet e Programit në raport me Shpenzimet e Përgjithshme



MENAXHIMI I MJEDISIT, PYJEVE DHE KULLOTAVE

Objektivat:

- Zbatimi i masave të propozuara të VSM-ve, PPV Bashkia Shkodër, si dhe VNM-ve për projektet e propozuara.
- Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet hartimit të planit të veprimit të zhurmave.
- Promovimi i i energjisë zero në objektet publike.
- Forcimi i pjesëmarrjes publike në takimet për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje të tij.
- Bashkëpunimi me institucionet e arsimit parauniversitar mbi promovimin e zhvillimit e qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Shkodër.
- Ndërtimi i kadastrës ujore në bashkinë Shkodër
- Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë.
- Hartimi/rishikimi i Planeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullor në bashkinë Shkodër.
- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullorë, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni (Projektim/Investim).

43,806
ha Pyje
160.2 lekë/ha
7,016,000
lekë

14 punonjës të
përhershëm
10 punonjës të
përkohshëm
7,236,000 lekë

36
monitorime
të kryera në
fondin pyjor
dhe kullor

2
Masa VSM për
PPV

1 hartë e
zhurmave
1 hartë e
subjekteve
ndotëse të
burimeve
ujore

15
subjekte të
evidentuara që
gjenerojnë
zhurmë

7
këshillime me
publikun në
kuadër të
mbrojtjes dhe
vlerësimit
mjedisor

86
subjekte të
evidentuara që
ndotin dhe
shfrytëzojnë
burime ujore të
bashkisë

5 botime
materilesh për
planin e
menaxhimit në
Nj.A Bërdicë.
50 botime
materialesh për
regjistrimin dhe
inventarizimin e
pyjeve dhe
kullotave ne Nj.A
Pult.

10 Ha rehabilitim
sipërfaqe pyjore
(Tarabosh)
550 Ha pyllëzim
11 Ha parcela
pyjore të
mirëmbajtura
5 investime për
luftimin e
sëmundjeve në
pyje
531 m3 mbrojtje
tokës nga
erozioni

Treguesi i Performancës

Eficiencia e përdorimit të buxhetit të alokuar për programin buxhetor të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave:

Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)

2017

284

2018

412


Raporti i Shpenzimeve të Programit me Shpenzimet e Përgjithshme

1%

99%


■ Shpenzimet e Programit (1%)
■ Shpenzimet e Përgjithshme

Realizimi i shpenzimeve të programit në mijë lekë



Raporti i shërbimeve të ofruar për arsimin dhe edukimin ndërmjet viteve 2017 dhe 2018

- shkolla të arsimit bazë me mirëmbajtje të zakonshme
- shkolla të arsimit bazë me mirëmbajtje rrjeti elektrik dhe hidraulik
- shkolla të arsimit bazë të mbështetura në mbarëvajtjen e procesit mësimor
- shkolla të arsimit bazë që i ofrohet ujë, energji, internet
- shkolla të arsimit të mesëm me mirëmbajtje të zakonshme
- shkolla të arsimit të mesëm me mirëmbajtje rrjeti elektrik dhe hidraulik
- shkolla të arsimit të mesëm të mbështetura në mbarëvajtjen e procesit mësimor
- shkolla të arsimit të mesëm që i ofrohet ujë, energji, internet



Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare. Bashkia Shkodër ka siguruar mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 11 njesitë administrative.

- ☛ **90 shkolla**
- ☛ **60 kopshte**
- ☛ **2 konvikte**
- ☛ **1 shkollë special**

Synimi i saj është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, si:

- ☛ **Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve),**
- ☛ **Edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve,**
- ☛ **Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (Parashkollor dhe të Qendrës Kulturore),**
- ☛ **punonjësit e shërbimeve mbështetëse të Arsimit të Mesëm dhe konviktet.**

7,853 m²

rikonstrukcione në godinat e arsimit bazë dhe të mesëm



56 pajisje TIK

të reja në shërbim të arsimit bazë dhe të mesëm



215 makineri

në shërbim të arsimit bazë dhe të mesëm të mirëmbajtura




ARSIMI DHE EDUKIMI


Objektivat:

- Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës.
- Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor.
- Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor, të sigurtë konform standarteve ligjore.
- Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese për fëmijë.

Numri i nxënësve përfitues nga shërbime e bashkisë në vitet 2017 dhe 2018




Realizimi i shpenzimeve të programit në mijë lekë



Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme

■ Shpenzimet e Programit ■ Shpenzimet e Përgjithshme




Treguesit e Performancës		2017	2018
Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor: Tërheqja e fëmijëve në sistemin parashkollor	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 0-6 vjeç (në %)	211%	198%
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar: - Mësues për nxënës - Nxënës në klasë ose grup klasash	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor – raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë	0%	1%
Efficienca e shërbimit të arsimit të përgjithshëm (mesëm)	Lekë të shpenzuara për një nxënës në shkollën e mesme (shpenzime operative dhe mirëmbajtje) kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin e mesëm publik	2734	984

“Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”

- ☞ Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
- ☞ Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.
- ☞ Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat e komunitetit.
- ☞ Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe Politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- ☞ Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
- ☞ Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, Gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.
- ☞ Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.
- ☞ Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovim dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.
- ☞ Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.
- ☞ Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.

Raporti i mbështetjes me shërbime sociale ndërmjet viteve 2017 dhe 2018

- Banorë përfitues të shërbimeve sociale në territorin e bashkisë
- Fëmijë në situatë rruge të mbështetur
- Persona të asistuar me pagesë pa aftësi dhe invaliditeti
- Familje të asistuar me ndihmë ekonomike
- Raste të referuara
- Përfitues nga funksionimi i sistemit të referimit
- Përfitues të shërbimeve egzistuese dhe alternative



Treguesit e Performancës

Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit nga viti paraardhës	Numri i aktiviteteve (trendi në %)	7%
	Numri i temave të zhvilluara (trendi në %)	-8%
	Numri i pjesëmarrësve (trendi në %)	640%

SHËRBIMET SOCIALE DHE STREHIMI

1 Plan Lokal Veprimi



për fëmijët në situatë rruge në të gjithë territorin e bashkisë

5 takime

të Grupit Teknik të Punës

18 tryeza

konsultaitve

19 OJF

pjesëmarrëse

7 aktivitete

ndërgjegjësuere

270 pjesëmarrës

58 takime informese

për shëndetin

1110 pjesëmarrës



1 Plan Veprimi

për Barazinë Gjinore



1 Sistem

statistikor të dhënash

10 partneritete

të nëshkruara me organizata dhe shoqërië civile



14 qendra

shëndetësore

funksionale

3 qendra shendetesore

te reja

173,029 përfitues



12 qendra komunitare

në territorin e bashkisë

6456 përfitues

shërbimesh

5 shërbime alternative të ofruara

130 punonjës të trajnuar



2 kënde lojrash

të rinj të ndërtuar



1 qendër rinore

12 shërbime

për të rinjtë

720 përfitues



55 fëmijë në nevojë



përformues në aktivitete artistiko kulturore

122 fëmijë jetimë

të asistuar dhe shërbyer përmes politikave sociale të bashkisë

50 fëmijë jetimë të mbështetur me rastin e festive të fundvitit



170 qenj të rrugës

të trajtuar



673 familje

përfituese të strehimit social

2006 aplikime

për përfitim

të strehimit social



1 Plan Lokal Zhvillimi

për komunikimin rom dhe egjiptian

1 Studim

vlërësim për strehimin e komunitetit



4 çerdhe të reja

178 foshnje


90 fëmijë

63 punonjës




Realizimi i shpenzimeve të programit në mijë lekë

■ Plan ■ Fakt



Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme

■ Shpenzimet e programit
■ Shpenzimet e përgjithshme




KULTURA DHE SPORTI

Shkodra, një trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me shtrirje nga Alpet deri në bregdet, do të bëhet faktor kyç për rritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve. Me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor.

- Përfitues nga aktivitetet kulturore të organizuara
- Lexues të rregullt në Bibliotekën e qytetit
- Vizitorë në muzeume dhe shtëpi muze
- Vizitorë në ekspozitë

Raporti i përfitimit të shërbimeve kulturore ndërmjet viteve 2017 dhe 2018



Objektivat:

- ☞ Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirë administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.
- ☞ Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës.
- ☞ Pasurimi dhe gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.
- ☞ Promovimi dhe nxitja e leximit si instrument edukimi duke rritur aksesin dhe cilësinë e shërbimit pranë Bibliotekës “Marin Barleti”.
- ☞ Ruajtja, mirë administrimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës “Marin Barleti”.

12 aktivitete kulturore




1 botim i revistës “Gegnia”




1 ndërtesë kulturore e mirëmbajtur



Realizimi i shpenzimeve të programit të kulturës në mijë lekë



Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme



- Shpenzimet e Programit
- Shpenzimet e Përgjithshme

KULTURA DHE SPORTI

Programi për rininë ofron shërbime specifike në lidhje me:

- a) Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj.,
- b) Vlerësimin e nevojës për mbështetje të rinjve;
- c) Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore;
- d) Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Kampionati i lojrave me dore ndermjet shkollave te mesme.
Maratona ePavaresise Ulqin-Shkoder.
Promovimi i lojes se Shahut ne Shkoder.
Beach Volley.
Revista Sportive "Vllaznia".
Memorial Vllazni 2018 ne Boks.
Mirenjohje per sportistet dhe trajneret me te mire.
Aktiviteti Xhudo "Nënë Tereza"

01

Çiklizem
Atletike
Menaxhim i Sport Klub "Vllaznia"
Mirëmbajtje e Stadiumit "Loro Boriçi"
Klubi i Futbollit "Vllaznia"

02

Mbeshtetje e skuadrave femra e meshkuj:
Basketboll
Volejboll
Gjimnastike
Handboll
Mundje
Not
Peshengritje
Ping Pong
Shah
Xhudo

03

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre. Nëpërmjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumësportësh "Vllaznia" dhe Klubi i futbollit "Vllaznia". Në përbërje të Klubit shumësportësh "Vllaznia" mbështeten ekipet në disiplina të ndryshme sportive.

21 ekipe sportive




5 aktivitete sportive




4050 pjesëmarrës në aktivitetet sportive në të gjithë territorin e bashkisë



Realizimi i shpenzimeve të programit të sportit dhe rinisë në mijë lekë




Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme



MBROJTJA NGA ZJARRI

RASTE TË MENAXHUARA PËR SHUARJEN E ZJARREVE

1 STACION
MZSH I
BASHKISË
SHKODËR



7 AUTOMJETE:


4 ZJARRËFIKËSE

1 AUTOSHKALLË

1 FURGON

1 FUORISTRADË

Realizimi i shpenzimeve të programit në mijë lekë




1 ZJARRËFIKËSE E
BLERË NË VITIN 2018
ME VLERË 1.316.577
LEKË



78 FAMILJE TË
MBËSHTETURA
FINANCIARISHT GJATË
VITIT 2018 PËR RASTE
E FATKEQËSIVE

Raporti i shpenzimeve të programit me shpenzimet e përgjithshme në mijë lekë



Treguesi i Performancës		2017	2018
Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit SHMZ	Total shpenzime për SHMZ kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara	21,355	23,414